



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

ZYRA E RREGULLATORIT PËR ENERGJI
REGULATORNI URED ZA ENERGIJU
ENERGY REGULATORY OFFICE



Prishtinë: 23.03.2023
Kodi i ZRRE-së: V_1681_2023

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

Duke u bazuar në:

- Nenin 9, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.7, nenin 15 dhe 17 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Nr. 05/L-084);
- Nenin 17 dhe 18 të Rregullës për Zgjidhjen e Ankesave dhe Kontesteve në Sektorin e Energjisë;
- Dëshmitë e paraqitura nga palët; dhe
- Rekomandimin e DMK-së të ZRRE-së: ZRRE/DMK_ R_2409_02_23.

në seancën e mbajtur më datë 23.03.2023 nxori këtë:

V E N D I M

- I. APROVOHET** si e bazuar ankesa e Operatorit të Sistemit të Transmisionit dhe Tregut (KOSTT SH.A.)
- II. DETYROHET** – Kompania Kosovare për Furnizim me Energji Elektrike (KESCO SH.A.) që t'i paguaj KOSTT SH.A., faturat për jo balanca për muajin korrik, gusht dhe shtator të vitit 2022, në shumën totale prej 11,445,280.58 Euro

A r s y e t i m

Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRE) me datë 12.12.2022 ka pranuar nga Operatori i Sistemit të Transmetimit dhe Tregut (KOSTT SH.A.), kërkesën për inicimin e kontestit kundër Furnizuesit me Shërbim Universal (KESCO SH.A.) lidhur me:

Kthimin e faturave për jo-balancet e shkaktuara së bashku me faturat e korrigjimeve për muajt korrik, gusht dhe shtator të vitit 2022.

KOSTT SH.A., në kërkesën e saj ka shpjeguar shkaqet e inicimit të kontestit duke theksuar se, si Operator i Tregut është i obliguar që të realizoj procesin e barazimit përfundimtar për të gjitha palët përgjegjëse për balancim në Zonën Rregulluese të KOSTT SH.A.

KOSTT SH.A., ka sqaruar se nga korriku i vitit 2022 deri në shtator të vitit 2022, se pala KESCO SH.A., nuk i ka pranuar dhe i ka kthyer prapa faturat në lidhje me jo-balancat e shkaktuara duke mos procuruar energjinë e nevojshme për mbulimin e furnizimit të konsumatorëve të shërbimit universal. Faturat që nuk janë pranuar në formë të rregullt nga ana e KESCO SH.A., janë dërguar edhe përmes postës, të cilat edhe përmes postës janë kthyer në KOSTT SH.A.A, nga KESCO SH.A., pa dhënë ndonjë arsyetim.

KOSTT SH.A., thekson se faturat e papaguara në mënyrë të rregullt por të dorëzuara përmes postës KOSTT i ka trajtuar dhe vazhdon ti trajtoj sipas Rregullave të Tregut par. 3.5.1(a)(iii) si dhe fatura për të cilat duhet të kryhet obligimi i pagesës.



Faturat e kthyera për jo-balancet e shkaktuara nga KESCO SH.A., i ka prezantuar edhe në formën tabelare dhe i ka prezantuar me prova, të cilat i ka bashkangjitur në dosjen e iniciuar të kontestit.

KOSTT SH.A., ka sqaruar se, energjia e tërhequr nga interkonekcionin në formë të jo-balancave për mbulimin e energjisë e nevojshme për llogarinë e mbulimit të furnizimit të konsumatorëve të shërbimit universal i është faturuar konsumatorëve si kosto pjesëmarrësve e tarifave fundore e cila është aprovuar nga ZRRE dhe mund të supozohet se edhe janë paguar.

KOSTT SH.A., ka theksuar se, ekziston përgjegjësia e pa kontestuar e KESCO SH.A., që të paguaj faturat për energjinë e tërhequr bazuar në legjislacionin e aplikueshëm, duke prezantuar referenca ligjore dhe interpretime ligjore në lidhje me kontestin e iniciuar.

KOSTT SH.A., thekson se me Ligjin për Energjinë Elektrike gjegjësisht dispozitat ligjore të nenit 16 paragrafit 1 nën paragrafi 1.19 detyrat dhe përgjegjësit e Operatorit të Sistemit të Transmisionit është balancimi i sistemit të energjisë elektrike me harmoni me Kodin e Rrjetit të transmisionit dhe Rregullat e Tregut, në nenin 25 paragrafin. 1 definohet që secili pjesëmarrës në treg të energjisë elektrike ka përgjegjësi për balancim, dhe neni 38 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 definojnë që furnizimin me energji elektrike si shërbim publik siapas kushteve të përcaktuara në licencë.

KOSTT SH.A., thekson se me Rregullat e Tregut gjegjësisht Nenin 18.2.2 theksohet se: Nga të gjitha palët tregtare kërkohet që të miratojnë të dhënat e Energjisë së Matur dhe të dhënat e faturave provizore në përputhje me procedurat e Rregullave të tregut të përpiluara në përputhje me paragrafin 5.1.2(b). Në qoftë se Palët tregtare dështojnë të konfirmojnë të dhënat e Energjisë së matur ose faturat provizore, vlerat do të konsiderohen se janë korrekte dhe OT do të vazhdoj procesin e faturimit.

Gjithashtu me nenin 18.3.3. të Rregullave të Tregut definohet se : Pala Përgjegjëse për Balancim (PPB) dhe Palët Tregtare do të paguajnë të gjithë shumën e parave për faturat që u janë lëshuar (dhe OT do të paguaj paratë që i takojnë PPB dhe Palëve Tregtare) jo më vonë se pesë (5) Ditë Pune pas lëshimit të faturës. Ndërsa neni 18.3.4. Për çdo mos-pagesë me kohë do të llogaritet kamata ligjore vjetore me shkallë interesi 4.5 % në vlerën e papaguar ashtu siç përcaktohet me Ligjin mbi Marrëdhëniet Detyrimore, përveç nëse shuma e papaguar trajtohet si çështje në mirëbesim.

Ndërsa nenin 18.5.2 theksohet se: Kur një PPB ose një Palë Tregtare ngre një Kontest Fature të vërtetë(bona fide) në të gjitha rastet obligimi për pagesën e kësaj fature duhet të bëhet deri në datën e caktuar. Kontest i vërtetë është kontesti që mbështetet në prova të sakta, ku provat e sakta definojnë si të dhëna origjinale që mbështesin vërtetimin e jo korrektësisë së Barazimit përfundimtar. Në rast të borxhit ndaj ose nga një Llogari e PPB ose Palës Tregtare, pagesa e shumës totale duhet të bëhet siç është faturuar.

Pra, sipas palës KOSTT SH.A., bazuar në nenet e lartcekura të Ligjit për Energjinë Elektrike, KESCO SH.A., është përgjegjës për balancim si dhe sigurimin e energjisë elektrike për mbulimin e furnizimit të konsumatorëve me shërbim universal si dhe konsumatorëve tjerë me ç' rast KESCO SH.A., ka bërë shkelje ligjore duke mos përmbushur obligimet në fjalë si dhe duke refuzuar pagesën e shërbimeve të pranuar.



KOSTT SH.A., thekson së bazuar në Nenin 4 të Rregullës për zgjidhjen e ankesave dhe kontesteve në sektorin e energjisë, ka kërkuar nga ZRRE zgjidhjen e kontestit në afat sa më të shkurtër kohor, respektivisht të detyroj KESCO SH.A., që të pranoj faturat për periudhën korrik-shtator 2022 dhe të paguaj të njëjtat sa më parë.

ZRRE me datë 10 janar 2023 përmes shkresës nr. prot. 010/2023 i ka përcjellë njoftimin për përgjigje të KESCO SH.A., lidhur me iniciimin e kontestit nga ana e KOSTT SH.A., nr. 2484 dt. 12.12.2022, për të paraqitur përgjigjet në lidhje me faturat e kontestuara për jo-balacet e shkaktuara s' bashku me faturat e korrigjimeve të jo-balancave për muajt korrik, gusht dhe shtator 2022.

KESCO SH.A., me datë 18.01.2023 ka ofruar përgjigjet në shkresën nr. 015 të datës 10.01.2023 " Përgjigje e KESCO SH.A., ndaj iniciimit të kontestit të KOSTT SH.A. kundër KESCO SH.A. lidhur me faturat e kontestuara për jo-balacet e shkaktuara s' bashku me faturat e korrigjimeve të jo-balancave për muajt korrik, gusht dhe shtator 2022.

KESCO SH.A., thekson se për shkak të krizës energjetike në mbar botën, sektori i energjisë në Kosovë është përballuar me rritje enorme të kostove e cila ka rezultuar me pasoja të likuiditetit për ndërmarrjet të cilat operojnë në sektorin e energjisë.

Po ashtu KESCO SH.A., ka theksuar se si rezultat i vonesave në alokimin e subvencionit nga Qeveria, me datë 10 gusht të vitit 2022 ka dërguar shkresë zyrtare tek të gjithë akterët përgjegjës të sektorit të energjisë duke i njoftuar se në gjendjen financiare në të cilën ndodhet kompania aktualisht është e detyruar të nominojë vetëm energjinë elektrike e cila prodhohet nga gjeneratorët vendor dhe i njëjti nuk mund të mbahet përgjegjës për asnjë devijim në sistemin interkonektiv dhe/apo ndonjë pasojë tjetër materiale dhe ligjore.

Ndërsa KESCO SH.A., thekson se me datë 12 gusht 2022, KESCO, në vazhdimësi të shkresës së datës 10 gusht 2022 kishte dërguar shkresën zyrtare KOSTT SH.A., duke kërkuar nga KOSTT SH.A., të ndërmerren të gjitha masat e nevojshme sipas legjislacionit në fuqi për të menaxhuar devijimet pasi që KESCO, nuk do t'i pranoj faturat për jo-balanca eventuale përderisa kostot për sigurimin e energjisë elektrike të nevojshme nuk mbulohen nga tarifat e të licencuarve në fuqi.

Gjithashtu KESCO SH.A., ka theksuar se lidhur me të lartpërmendurat, KESCO SH.A., ka dërguar shpjegime në KOSTT SH.A., gjatë refuzimit të faturave përkatëse, përfshirë këtu faktin se mungesa e mjeteve financiare e ke detyruar ne marrjen e masave për nominimin e energjisë së prodhuar në vend . Megjithëkëtë, KESCO pas alokimit të vazhdueshëm të subvencionit nga Qeveris dhe pas analizimeve të bëra pjesërisht mund të pranoj faturat për jo-balanca dhe faturat e korrigjimeve të jo-balancave përkatësisht mund të pranoj vetëm pjesën e faturës se jo-balancave si rrjedhojë e nominimeve të bëra nga KESCO për atë periudhë. Kjo për shkak se KESCO ka bërë të gjitha paralajmërimet e nevojshme tek të gjithë akterët e sektorit se për shkak gjendjes së rëndë financiare është detyruar të nominojë vetëm energjinë e cila prodhohet në vend, ndërsa KOSTT SH.A., lidhur me këtë nuk i është përmbajtur saktësisht kërkesës për reduktimin e energjisë në nivel të nominimeve, dhe si rezultat KESCO SH.A., nuk mund të pranoj faturat e jo-balancave gjatë kohës kur janë aplikuar kufizimet, sipas udhëzimeve të KOSTT SH.A. Gjithashtu ka prezantuar një tabelë të vlerave të kontestuara.



Në fund ka theksuar se KESCO, në dhjetor të vitit 2022 ka dërguar në ZRRE, aplikimin për shqyrtim të jashtëzakonshëm të të Hyrave të Lejuara Maksimale në të cilën ka përfshirë edhe faturat e kontestuara për jo-balancave për muajt korrik-shtator 2022. Përkatësisht nëse këto kosto të njihen si të plota nga ZRRE, KESCO do t'i pranoj faturat e kontestuara, në të kundërtën të njëjtat nuk mund të pranohen nga KESCO.

ZRRE ka bërë administrimin e provave dhe atë: Shkresën Nr.2152 të datës 26.10.2022, Shkresën Nr.2308 të datës 16.11.2022 dhe Shkresën Nr. 2419 të datës 05.12.2022, Shkresën Nr. 2425 të datës 06.11.2022, Shkresën e KESCO Nr. 61 të datës 26.10.2022, Shkresën Nr. 70 të datës 17.11.2022, dhe Shkresën Nr. 05 të datës 18.01.2023.

Analiza e kontestit

ZRRE vlerëson kontestin e iniciuar nga KOSTT SH.A., në përputhje me Nenin 17 par. 1 nënpar. 1.2 të Ligjit për Rregullatorin për Energji dhe Nenin 17 dhe 18 të Rregullës Nr. 04/2017 për zgjidhjen e ankesave dhe kontesteve në sektorin e energjisë dhe provave të administruara në seancën e shqyrtimit, ku ka konstatuar se kërkesa e KOSTT SH.A. është e bazuar.

ZRRE vlerëson se bazuar në provat e administruara, vërtetohet se KESCO SH.A. në muajt korrik, gusht dhe shtator 2022, nuk ka prokuruar blerje të energjisë për mbulimin e furnizimit të konsumatorëve përtej sasive të prodhuara nga KEK, duke lenë sasi të caktuara të kërkesës së KESCO-s SH.A., të pambuluara në aspektin ligjor.

Në praktikë, kjo do të thotë që konsumatorët janë furnizuar me energjinë elektrike, ku si rezultat i këtij furnizimi ka pasur mos-balancim të vazhdueshëm në mes të konsumit të energjisë elektrike në vend dhe energjisë së ofruar nga operatorët përgjegjës në treg, në këtë rast KESCO SH.A., ka shkaktuar disbalanca të konsiderueshme në sistemin e interkonjeksionit. Nga kjo shihet qarët se KESCO SH.A., për të ju shmangur blerjes (importit) të energjisë elektrike përtej sasive që mbulohehen nga gjenerimi i KEK SH.A., pavarësisht njoftimeve nga ana e Operatorit të Tregut (OT), me dashje ka nominuar sasi më të vogla të energjisë në raport me kërkesën e tij. Ky veprim i KESCO-s SH.A., është në kundërshtim me Nenin 34 pika 1, Nenin 38 pika 1 të Ligjit për Energjinë Elektrike.

Po ashtu nga shkresat e lëndës vërehet se KESCO SH.A., nuk ka kontestuar energjinë e matur dhe nuk ka prezantuar prova për jo korrektësinë e barazimit përfundimtar, andaj, faturat për muajin korrik, gusht dhe shtator të vitit 2022 të përgatitura nga KOSTT SH.A., për pagesën e jo balancave siç parashihet në Nenin 15 dhe Nenin 16 të Rregullave të Tregut janë korrekte dhe të sakta. Kthimi i faturave nga KESCO SH.A., nuk ka asnjë mbështetje ligjore dhe si të tilla janë në kundërshtim të plotë me Rregullat e Tregut. Për më tepër, vlen të theksohet se Neni 15.5.2 i Rregullave të Tregut përshkruan në mënyrë shprehimore, se kur një Palë Tregtare ngre një kontestim fature, në të gjitha rastet obligimi për pagesën e kësaj fature duhet të bëhet deri në datën e caktuar në faturë. Mos pranimi i faturave dhe kthimi i tyre nga KESCOSH.A., pa mbështetje ligjore, ka shkaktuar pasoja materiale për KOSTT SH.A.

Për sa u përket pretendimeve të KESCO-s, se mos pranimi i faturave dhe kthimin e tyre përmes shkresave zyrtare mbështetet në tri arsye të cekura në vazhdim:



- Nominimin vetëm në sasinë e prodhuar në vend për arsye të gjendjen financiarë;
- Njohjen e kotove të sigurimit të energjisë së nevojshme në tarifa; dhe
- Mos menaxhimin e duhur të devijimeve nga KOSTT SH.A.

ZRRE vlerëson me të drejt se asnjëra nga këto tri arsye nuk mbështet në dispozita ligjore për sa i përket pagesave të faturave për energjinë e jo balancave, dhe pretendimet e KESCO SH.A., nuk qëndrojnë dhe si të tilla i konsideron veprime të kundërligjshme dhe jo të drejta.

ZRRE vlerëson se, deklaratimet e KESCO SH.A., se do të nominojë vetëm sasinë e energjisë së prodhuar nga gjeneratorët vendorë dhe nuk do të mbahet përgjegjës për asnjë devijim bie në kundërshtim me Nenin 34 dhe 38 të Ligjit për Energjinë Elektrike. Këto dispozita ligjore kërkojnë që KESCO SH.A., duhet të ndërmerret aktivitetin energjetik të furnizimit në mënyre të sigurt, të besueshme, sigurojnë furnizimin me energji elektrike si shërbim publik sipas kushteve të licencës.

Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRE) më datë 9 gusht 2022 ka pranuar aplikimin për Shqyrtim të Jashtëzakonshëm të Të Hyrave të Lejuara Maksimale për KESCO. Ndër të tjera, në kërkesën e saj KESCO thekson se në mungesë të rimbursimit të mjeteve të subvencionit nga Qeveria e Republikës së Kosovës të shumës prej 32.8 milion eurove për periudhën 9 shkurt – 30 qershor 2022 është tejkaluar pragu i materialitetit prej 5% siç përcaktohet në Rregullën e të Hyrave të KESCO, duke mundur kështu hapjen e shqyrtimit të jashtëzakonshëm.

ZRRE në përputhje me Rregullën për Përcaktimin e të Hyrave të Lejuara, ka analizuar me kujdes aplikacionin e KESCO, dhe konstaton se ngjarja e jashtëzakonshme nuk ka qenë nën kontrollin e FSHU-së, dhe se mungesa e subvencionit të Qeverisë së Republikës së Kosovës do të tejkalonte pragun e materialitetit prej 5% në të Hyrat e Lejuara Maksimale të FSHU-së, e cila do të hapte Shqyrtimin e Jashtëzakonshëm të tarifave për konsumatorët që gëzojnë të drejtën e shërbimit universal.

Më datë 24 gusht, Qeveria e Republikës së Kosovës në mbledhjen e saj me anë të vendimit nr. 21/94 në bazë të interesit publik dhe interesit të përgjithshëm ekonomik, me qëllim të sigurimit të furnizimit të rregullt me energji elektrike dhe në mënyrë që te mbahet përballueshme ia e çmimit të energjisë elektrike për konsumatorët fundorë që gëzojnë të drejtën e furnizimit universal, kompanisë që vepron si Furnizues i Shërbimit Publik (FShU) i ka vendosur obligimi shtesë të shërbimit publik. Ndërsa, me anë të vendimit nr. 23/94 ka aprovuar kërkesën e Ministrisë së Ekonomisë për ndarje buxhetore në shumë prej 41 milion euro lidhur me Pakon e Ringjalljes Ekonomike për zbatimin e Masës 3.7 – Mbështetje në tejkalimin e krizës energjetike.

ZRRE konstaton që vendimi i Qeverisë së Republikës së Kosovës nr.21/94, ka neutralizuar ndikimin në tejkalimin e kostove të furnizimit me energji elektrike për konsumatorët e rregulluar dhe njëherit kanë pushuar rrethanat për Shqyrtim të Jashtëzakonshëm të Të Hyrave të Lejuara Maksimale të FSHU-së, respektivisht të tarifave të energjisë elektrike për konsumatorët me të drejt të Shërbimit Universal.

ZRRE vlerëson se KESCO, në deklaratimet e saj ka theksuar se nuk do t'i pranojë faturat për jo balanca për derisa kostot për sigurimin e energjisë së nevojshme nuk mbulohen në tarifa, dhe si të tilla nuk ia fali besimin për faktin se me asnjë fakt qoftë formal apo material nuk ka prezantuar prova konkrete në shkresat e lëndës se kostot për blerjen e energjisë janë tejkaluar.



ZRRE po ashtu vlerëson se KESCO, Gjatë muajve korrik, gusht dhe shtator të vitit 2022, ka nënominuar në mënyrë konsistente në raport me konsumin e tyre dhe, si rezultat, sistemi elektroenergetik i Kosovës ka tërhequr në mënyrë të pa-autorizuar energji elektrike nga sistemet fqinje. Duhet theksuar se energjia e tërhequr nga interkonkesioni në formë të jo balancave për mbulimin e furnizimit me energji elektrike është konsumuar nga konsumatorët, dhe si rezultat i kësaj duhet edhe të paguhet.

ZRRE vlerëson se KOSTT SH.A., ka vepruar drejt dhe ka zbatuar kornizën ligjore ku ka përgatitur faturat për energjinë e tërhequr në formë të ja balanceve, të cilat i ka dërguar në KESCO-s., por kjo e fundit nuk i ka pranuar e për të cilën KESCO SH.A., e ku vërtetohet fakti se KESCO SH.A., ka vepruar në kundërshtim me dispozitat ligjore në fuqi të cekura më lartë.

ZRRE vlerëson se, në bazë të Rregullave të Tregut, gjegjësisht Nenin 11, Nominimet Fizike, Nominimet Kontraktuale, Ofertat për Shitje dhe Ofertat për Blerje par. 11.1.9, 'Palët Tregtare të ndihmojnë OST në kryerjen e obligimeve ndaj ENTSO-E për minimizimin e Devijimeve të Paqëllimshme. Palët Tregtare janë përgjegjëse të sigurojnë që injektimi dhe konsumi momental të jetë sa më afër vlerës që është nominuar tek OT nga ana e tyre.

Në këtë kuptim, në bazë të Kodit të Balancit, Neni 2.5.1.2, OST do të njoftojë palët e tregut të energjisë elektrike për çdo periudhë apo periudhë potenciale të pamjaftueshmërisë së furnizimit duke pritur që KESCO të ndërmarr masat e nevojshme, KOSTT SH.A., vazhdimisht ka njoftuar palën që të ndërmerr masat e nevojshme për plotësimin e kërkesës.

ZRRE vlerëson se KOSTT SH.A., në rolin e Operatorit të Tregut është i obliguar që të realizojë procesin e barazimit përfundimtar për të gjitha palët përgjegjëse përfshirë edhe KESCO SH.A., për balancim në zonën rregulluese dhe në mënyrë të drejtë për energjinë e jo-balancave e ka faturuar KESCO SH.A., për muajt korrik, gusht dhe shtator 2022, duke zbatuar drejt dispozitat ligjore në fuqi.

Andaj, referuar shkresave të lëndës dhe administrimit të provave, vërtetohet se KESCO SH.A. mban përgjegjësi të plotë që të përmbush obligimet ligjore në lidhje me faturat e jo balancave për muajt korrik, gusht dhe shtator 2022, dhe ta paguaj shumën totale prej 11,445,280.58 Euro

Bordi i ZRRE duke pasur parasysh të gjitha faktet e përmendura më lartë, dëshmitë dhe argumenteve të paraqitura nga palët në kontest, ka vlerësuar se kërkesa e KOSTT SH.A., është e bazuar, dhe duke u mbështetur në dispozitat ligjore të Ligjit për Energjinë Elektrike Nr. 05/L-085, Rregullat e Tregut, pas analizimit të kësaj që u theksua më lartë, ka vendosur si në dispozitivin e këtij vendimi.


- III. Vendimi nxirret në gjuhën shqipe dhe do të përkthehet në gjuhën serbe dhe angleze. Në rast të mospërputhjes në mes të versioneve, do të mbisundojë versioni në gjuhën shqipe.
- IV. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi, dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.




Këshillë Juridike: Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodhë e fundit.

Bordi i ZRRE-së:


Ymer Fejzullahu, Kryesues


Lutfije Dervishi, anëtare


Gani Buçaj, anëtar

Vendimi iu dërgohet:

- Të licencuarit: KOSTT
- KESCO-së dhe
- Arkivit të ZRRE-së.